1.6.	Anëtar i Këshillit editorial të <i>Kirklareli University Journal of the faculty of Economics and Administrative science</i> , 7/2 (2018).	2
1.7.	Anëtar i Këshillit organizativ të Konferencës së 5-të shkencore ndërkombëtare: <i>The Rule of Law and Civil Society</i> , Fakulteti Juridik, Universiteti i Tetovës, 19-20 tetor, 2018.	1
1.8.	Anëtar i Këshillit editorial të <i>International Refereed Scientific Journal Vision</i> , 1/1 (2017).	2
1.9.	Anëtar i Këshillit shkencor të Konferencës së 4-të shkencore ndërkombëtare: <i>Security Challenges and Universal Standards in the Euro-Atlantic Integration Process</i> , 17-18 nëntor, 2017, Fakulteti Juridik, Universiteti i Tetovës.	2
<b>2.</b>	<b>Funksion në fakultet</b>	<b>30</b>
2.1.	Koordinator për Master në Fakultetin Juridik në Universitetin e Tetovës (2020-vazhdon).	3
2.2.	Koordinator për Projekte në Fakultetin Juridik në Universitetin e Tetovës (2020-vazhdon).	3
2.3.	Pjesëmarrje në aktivitete promovuese të fakultetit(2016, 2017, 2018, 2019, 2020).	5
2.4.	Anëtar i Komisionit për përgatitjen e programit studimor të ciklit të parë (2019).	1
2.5.	Kryetar i Komisionit për përgatitjen e programit studimor të ciklit të dytë (2020).	3
2.6.	Anëtar i Komisionit për përgatitjen e programit studimor të ciklit të tretë (2020).	1

2.7.	Anëtar i Komisionit të fakultetit për evaluim dhe cilësi	1
2.8.	Anëtarë i Komisionit për verifikimin e notave të studentëve të diplomuar në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës, nga data 01.02.2018	1
2.9.	Anëtar i komisionit për transfere të studimeve në ciklin e dytë të Fakultetit Juridik	1
2.10.	Anëtarë i Këshillit Mësimor Arsimor të Fakultetit Juridik në Universitetin të Tetovës, nga dhjetori i vitit 2016	1
2.11.	Ditët e hapura USHT, prezantim i programeve studimore në kuadër të Fakultetit Juridik, viti 2016, 2017, 2018, 2019,	4
2.12.	Pjesëmarrës - panelist në debatin e organizuar nga Fakulteti Juridik, në lidhje me ditën e Evropës. 9 Maj 2017.	2
2.13.	Pjesëmarrës dhe organizator i studentve të Fakulteti Juridik, në garat e mbajtura në Manastir për ditën e Evropës. 9 Maj 2018.	2
<b>3.</b>	<b>Recensentë</b>	
3.1.	Recensentë i librit të Qendrës për Paqe dhe Komunikim Transkulturore me titull “Gjuha e urrejtjes gjatë kampanjës së zgjedhjeve parlamentare 2020 në RMV”	2
	<b>Gjithsej</b>	<b>48</b>

<b>REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATIT PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJEN</b>	<b>Pikët</b>
<b>VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE</b>	<b>80.45</b>
<b>VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE</b>	<b>35.6</b>
<b>VEPRIMTARITË NË INTERES TË GJERË</b>	<b>48</b>
<b>Gjithësej</b>	<b>164.05</b>

Tetovë, 25.06. 2021

**KOMISIONI RECENSUES:**

1. Prof. Dr. Ylber Sela - kryetar

2. Prof. Dr. Bashkim Selmani - anëtar

3. Prof. Dr. Shefik Shehu - anëtar



**RAPORT I KOMISIONIT RECENSUES PËR ZGJEDHJE - RIZGJEDHJE TË NJË  
MËSIMDHËNËSI NË TË GJITHA THIRRJET MËSIMORE - SHKENCORE NË  
FAKULTETIN JURIDIK NË UNIVERSITETIN E TETOVËS**

Në bazë të konkursit për zgjedhje-rizgjedhje të mësimeve në Universitetin e Tetovës të datës 09.06.2021, të shpallur në gazetën “Koha” dhe “Sloboda Peçat” dhe në faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës, për zgjedhjen-rizgjedhjen e një mësimeve për lëndë mësimore në fushën e shkencave politike në kuadër të Fakultetit Juridik, konkretisht për fushën shkencore:

**- Marrëdhënie ndërkombëtare dhe historia e diplomacisë**

me propozim të Këshillit Mësimor – Shkencor të Fakultetit Juridik numër 13-522/1 të datës 24.06.2021 është formuar Komisioni Recensues në përbërje:

- 1. Prof. Dr. Shefik Shehu, profesor inordinar - kryetar,**
- 2. Prof. Dr. Ali Musliu, profesor inordinar - anëtar,**
- 3. Doc. Dr. Ebrar Ibraimi, docent - anëtar.**

Komisioni Recensues, pas shqyrtimit të dokumentacionit në lidhje me konkursin e lartpërmendur dhe në përputhje me nenin 132 të Ligjit për arsim të lartë (“Gazeta Zyrtare e RMV-së” numër 82/2018), Statutin e Universitetit të Tetovës, si dhe Rregulloren për kriteret e veçanta dhe procedurën për zgjedhje-rizgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, mësimore, mësimore- profesionale dhe thirrjet e bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës, i paraqet Këshillit Mësimor–Shkencor të Fakultetit Juridik të Universitetit të Tetovës këtë:

**RAPORT RECENZUES**

Në konkursin e datës 09.06.2021, të shpallur në gazetën “Koha” dhe “Sloboda Peçat” dhe në faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës, për zgjedhjen-rizgjedhjen e një mësimeve për fushën shkencore:

**- Marrëdhënie ndërkombëtare dhe historia e diplomacisë**

në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës, u paraqit kandidati:

- Dr. Gjeraqina Leka**

Komisioni Recensues ka nderin të paraqesë këtë:

## R E F E R A T

### I. Të dhënat biografike, përgatitja profesionale-shkencore dhe aktiviteti pedagogjik

Gjeraqina Leka lindi në Tetovë, me 18 prill, 1990. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, në shkollën “Bratstvo Migjeni”. Në 2004 ajo u regjistrua në shkollën e mesme, gjimnazin “Kiril Pejçinoviç” në Tetovë. Ndjekjen e mësimin në këtë shkollë e ndërpreu në dhjetor të 2004, pasi u shpërngul në Kajro të Egjiptit, ku vijoi mësimin në shkollën e mesme amerikane “the American International School in Egypt”. Pas dy viteve të shkollimit të mesëm, në vitin e tretë dhe të katërt, u bë pjesë e programit të Maturës Ndërkombëtare (International Baccalaureate). Në përfundim të vitit të katërt, ajo u diplomua nga kjo shkollë në vitin 2008, duke marrë diplomë të dyfishtë: amerikane dhe të Maturës Ndërkombëtare. Gjatë diplomimit, ajo u shpall nxënësja më e mire e gjeneratës (salutatorian).

Në shtator të po të njëjtit vit, ajo I regjistroi studimet në ciklin e parë, në Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë, në fushën studimore Shkencat Politike. Ajo u diplomua në vitin 2011, me notë mesatare 10.00, me çfarë u shpall si studentja më e mirë e gjeneratës.

Në shtator të vitit 2011, ajo I regjistroi studimet e ciklit të dytë, në programin e Diplomacisë, pranë UEJL. Ajo u diplomua në vitin 2014, pas mbrojtjes së punimit të magistraturës me temë: “Roli i qeverive të koalicionit në hartimin e politikave të jashtme: Maqedonia si një rast studimi.” Ajo fitoi gradën Magjistër i Diplomacisë, ndërsa këtë cikël të studimeve e përfundoi me notë mesatare 9.93.

Në vitin 2015 ajo i regjistroi studimet e ciklit të tretë, në programin Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Menaxhimi i Konfliktëve, pranë Fakultetit Filozofik (Katedra e UNESCO-s) në Universitetin Shën Kirili dhe Metodi. Ajo i përfundoi këto studime pas mbrojtjes së disertacionit, nën mentorimin e Prof. Dr. Michael Schulz (Universiteti i Gothenburg, Suedi) me temë: “Ndikimet e jashtme mbi politikën e jashtme dhe marrëdhëniet ndëretnike: rasti i Maqedonisë së Veriut”, dhe me notë mesatare 9.62, në janar të 2021.

Përvoja e saj e punës filloi me punësimin në Kabinetin e Zëvendëskryeminstres për Çështje Evropiane, në Sekretariatit për çështje evropjane, pranë Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, në 2012. Ndër aktivitetet kryesore të saj ishin mbajtja e agjendës ditore të ZK për Çështje Evropiane dhe koordinimi i aktiviteteve të kabinetit, mbajtja e korrespondencës me institucione të vendit dhe ndërkombëtare, pjesëmarrja në takim me zyrtarë të huaj, përgatitja e kumtesave për shtyp, etj.

Në vitin 2013 ajo u transferua me vend pune në Komunën e Tetovës ku punoi në Zyrën për marrëdhënie ndërkombëtare deri në vitin 2018. Detyrat e saj binin në rrafshin e marrëdhënieve ndërkombëtare, të përqendruara në bashkëpunimin me institucione e partnerë ndërkombëtarë. Gjatë punës së saj në këtë zyrë, Dr. Leka ishte e angazhuar kryesisht në inicimin dhe realizimin e binjakëzimeve midis Komunës së Tetovës dhe disa komunave/bashkive ndërkombëtare, siç janë Komuna Vil, Zvicër; Kolding, Danimarkë; Bandırma, Turqi; Cluj-Napoca, Rumani; etj. Ajo poashtu ka qenë përgjegjëse për aplikimin, implementimin dhe koordinimin e projekteve ndërkombëtare. Ndër më të rëndësishmet, të realizuara gjatë punës së saj në këtë komunë janë projekti “Promovim i paqes përmes bashkëpunimit të nxënësve multi-etnik” në kuadër të programit për bashkëpunim të

decentralizuar midis Normandisë së poshtme dhe Republikës së Maqedonisë, mbështetur nga Asociacioni i agjencive për demokraci lokale, Strasburg (2015); Projekti Vendosja e Sistemit të Integritetit, mbështetur nga UNDP (2010-2015); Projekti POWER (Rrjeti Evropian i Grave Kryetare Komunash) financuar nga Komisioni Evropian (2014-2016); Projekti Municipal Service Delivery (Ofrimi i Shërbimeve Komunale), miratuar nga Departamenti i Shtetit të SHBA-së (2016); projekti OKR (Punë e dobishme komunale) mbështetur nga UNDP, Ministria e Punës dhe politikës sociale dhe Agjensioni për Punësim (2017); etj. Gjatë punës së saj në Komunën e Tetovës, Dr. Leka ka qenë e emëruar si Personi Përfaqësues i Komunës në Qendrën Informative të BE-së (EU info point). Në krye të kësaj detyre ajo ka qenë e angazhuar në realizimin e shumë akviteve midis Delegacionit të BE-së dhe Komunës së Tetovës, përfshirë organizimin e Ditës së Evropës, 9 Majin, organizim të nxënësve e stafeve arsimore për ndjekje seminaresh, trajnimesh, ligjëratash në EU info qendrën, organizimin e vizitave të zyrtarëve të BE-së në aktivitete komunale, etj.

Në prill të po të njëjtit vit ajo u bë pjesë e Universitetit të Tetovës e angazhuar kryesisht në kuadër të Zyrës së Përkthimeve dhe Zyrës për Përpilimin dhe Menaxhimin e Projekteve. Në kuadër të punës së saj si pjesë e Zyrës së Përkthimeve, Dr. Leka ka realizuar, përkthimin e lajmeve, fjalimeve, raporteve, përfshirë dhe përkthimin dhe lekturimin e disa revistave shkencore dhe raporteve siç janë:

- International Journal of Human Sciences "Filologjia" numri special për Nënë Terezë.
- International Journal of Educational Research "Education" 2019
- International Journal of Applied Sciences 2019
- International Journal of Sports and Health 2018
- International Journal of Social and Human Sciences "Philosophica" 2018
- Inclusion of stakeholders in the development of study programs' curricula: a need for improving higher education quality, Report, 2019.

Së fundmi, Dr. Leka është përfshirë në recensionin e artikujve shkencorë të dorëzuar për botim në revistën *Justicia*.

Në kuadër të angazhimit të saj në aktivitetet e Zyrës për Përpilim dhe Menaxhim të projekteve, Dr. Leka, ka marrë pjesë në disa aktivitete siç është Punëtorja për Evropën Kreative (Kategoria: projekte për bashkëpunim), organizuar nga Ministria e Kulturës, trajnimi nga Western Balkan Fund, etj. Dr. Leka është edhe autore projektit: 'Kultivimi i bashkëjetesës përmes respektimit të identitetit të tjetrit,' i cili u miratua nga Ministria e Kulturës, në konkursin vjetor të 2020 për finansimin e projekteve me interes kombëtar. Aktualisht, Dr. Leka është koordinator e projektit Djep i ekselencës në shkencat shoqërore dhe humane (Cradle for excellence in social sciences and humanities), i cili bën pjesë në shtyllën e ekselencës, Horizon Europe, dhe i cili ka për qëllim ndërtimin e një platforme për këmbim dijeshe dhe përpilim propozimesh për HEU, në mbështetje të stafit kompetent për projekte, në shkencat e lartëpërmendura. Partnerë në këtë projekt janë Palacky University në Çeki, University of Innsbruck në Austri, V.N. Karazin National University Kharkiv në Ukrainë, dhe ekspertë të jashtëm.

Paralelisht me punën e saj administrative në Rektoratit të UT-së, në vitin 2018 ajo u angazhua edhe në mësimdhënie në lëndën: Të drejtat e Njeriut. Në vitin vijues, ajo u angazhua

përmes kontratës në vepër në mësimdhënie në katedrën e Studimeve politike të Fakultetit juridik, duke ushtruar funksionin e asistentes në lëndët:

- Hyrje në Shkencat Politike
- Integrimet në BE
- Analizë e Politikës së Jashtme
- Politika e Jashtme e SHBA-së

Në dhjetor të vitit 2019 ajo u emërua përgjegjëse e Zyrës për Përpilimin dhe Menaxhimin e Projekteve. Në kuadër të këtij angazhimi, u realizuan një sërë aplikimesh dhe zgjërime të rrjeteve të bashkëpunimit me institucione vendore dhe ndërkombëtare. Fokusi i punës së Dr. Lekës, në krye të kësaj zyre është pjesëmarrja e gjërë në projekte me interes të përgjithshëm si dhe në ndërkombëtarëzimin e mëtejshëm të universitetit përmes bashkëpunimeve në kuadër të programeve ndërkombëtare siç janë Erasmus +, Horizon 2020, IPA, Fulbright, USAID, CEEPUS network, WBF, si dhe përmes bashkëpunimit bilateral me institucione vendore dhe ndërkombëtare.

Ndër aktivitetet kryesore të realizuara gjatë ushtrimit të detyrës së përgjegjëses në këtë zyrë, vlen të veçohen realizimi i projektit në kuadër të Fulbright, me temë ‘Kornizë për Përmirësimin e Strategjive dhe Teknikave të Hulumtimit’, i cili mundësoi ardhjen e Specialistes së lartë për hulumtim, Dr. Janet Schoffield, në Universitetin e Tetovës. Qëndrimi i saj një muaj, rezultoi në një punë të suksesshme, të përqendruar në skanimin e gjendjes në sferën e hulumtimit, dhe në hartimin e një raporti me rekomandime, të bazuar në katër strategji të gjëra të cilat Universitetit të Tetovës i shërbejnë për rritjen e kualitetit dhe kuantitetit të hulumtimit, e të cilat poashtu shoqërohen nga një numër veprimesh specifike, të nevojshme për implementimin e këtyre strategjive.

Gjatë punës së saj në krye të kësaj zyre, janë realizuar edhe një numër projektesh, ndër të tjera projekti Art Bloom (në kuadër të Erasmus + KA2), projekti për Valorizimin e Malit Sharr, mbështetur nga UNEP dhe Ministria e Ambientit Jetësor, pjesëmarrja, në cilësinë e partnerit të asocuar, në aktivitetet e projektit Aleance e AURORA-s (Aurora Alliance në kuadër të Erasmus +), përkrah universiteteve të tjera prestigjioze siç janë Vrije Universiteit Amsterdam, University of Iceland Copenhagen, Business School University of East Anglia, Univerzita Palackého v Olomouci, anëtarësimi i Fakultetit Juridik në Asociacionin Evropian të Fakulteteve të Drejtësisë (European Law Faculties Association), realizimi i Seminarit të XIV Ndërkombëtar i Albanologjisë, si pjesë e projekteve të fituara nga Ministria e Kulturës në thirrjen e vitit 2020, ripërtirja e aplikimeve në rrjetin e CEEPUS III, realizimi i trajnimeve profesionale të studenteve femra nga departamenti i IT-së dhe Fakultetit të Shkencave të Zbatuara nga Instituti për Lidërsip dhe Politika Publike, realizimi i projektit Cyber Hygiene e-learning course, mbështetur nga CRDF Global, dy mini grant projekte: CROSS (për përpilim propozimesh/projektsh në Horizon Europe) dhe OS Galileo (open science), etj. Gjatë kësaj periudhe është bashkëpunuar ngushtë dhe me vullnetarin nga Korpusi i Paqes, me të cilin janë realizuar disa aktivitete, si aplikime për logjistikë në Ambasadën Gjermane, aplikim në programin Alumni Engagement Innovation Fund 2020, pjesëmarrja në Punëtoritë virtuale me temë Dizajnimi dhe Menaxhimi i Projekteve: Mjetet PACA’, etj.

Poashtu, gjatë periudhës 18 mujore në krye të kësaj zyre, Dr. Leka ka realizuar dhe koordinuar, edhe një sërë aplikimesh të reja, në kuadër të programit Erasmus +, Horizon 2020, Horizon Europe, Institucioneve shtetërore (Ministrisë së Kulturës, Ministrisë së Ambientit jetësor, Ministrisë së Arsimit, Byrosë për Zhvillim Rajonal), Institucioneve ndërkombëtare

(Ambasadës Amerikane, Ambasadës Gjermane, OSBE, UNDP, USAID, Korpusit të Paqes, MAAA, GIZ,) etj.

## II. Punimet e publikuara të kandidatit

Dr. Leka është e përfshirë në një sërë aktiviteteve hulumtuese me karakter shkencor. Fushat e interesit të saj përfshijnë Marrëdhëniet Ndërkombëtare, ndërsa në plan më të ngushtë, interesat e saj shtrihen në fushën e politikës së jashtme, e sidomos të politikës së jashtme të shteteve të vogla. Këto interesa shkencore e akademike ajo i reflekton në punimet shkencore e në pjesëmarrjet në konferenca akademike.

Puna e saj hulumtuese-shkencore reflektohet nga botimet në vijim:

1. **Gjeraqina Leka:** Security oriented foreign policy: theoretical approach, *International Journal of Legal Sciences*, Vol. 9 No. 13-14, Jun. 2021.
2. Shefik Shehu & **Gjeraqina Leka:** Gjuha e urrejtjes: një pasqyrim normativ (në botim), Botim i veçantë në kuadër të projektit hulumtues: Hate speech during the campaign of the 2020 parliamentary elections in the RNM: perceived effects on the behaviour of citizens in intergroup relations, Universiteti i Tetovës, 2020
3. **Gjeraqina Leka:** The role of foreign policy threats on inter-ethnic relations, *International Journal of Innovation and Scientific Research*, Vol. 49 No. 1 Jun. 2020, pp. 197-205
4. **Gjeraqina Leka:** North Macedonia within the western Balkan sub-regional security complex: A theoretical approach, *International Journal of Innovation and Scientific Research*, Vol. 49 No. 2 Jul. 2020, pp. 206-215
5. Shefik Shehu & **Gjeraqina Leka:** Small States' Security Through International Integrations: A Theoretical Approach, *Justicia*, Vol. 8, pp.199-206

Dr. Leka është paraqitur për pjesëmarrje edhe në konferenca vendore dhe me karakter ndërkombëtar, siç janë:

1. **Small States' Security Through International Integrations: A Theoretical Approach**, prezantuar në: 6th International Scientific Conference of Law "European Perspective of the Western Balkans", Universiteti i Tetovës, 13-15 nëntor 2019
2. **Methodology of Empirical Data Collection**, prezantuar në Konferencën Vjetore të Fakultetit Filozofik, Universiteti Shën Kirili dhe Metodi, 13 maj 2019
3. **The Interplay between Domestic and Foreign Policy**, prezantuar në Konferencën Vjetore të Fakultetit Filozofik, Universiteti Shën Kirili dhe Metodi, 25 prill 2018
4. **To what extent does the halt of the EU integration process fuel nationalistic policies in Macedonia and consequently contribute to the inter-ethnic instability of the country?** prezantuar në Konferencën Vjetore të Fakultetit Filozofik, Universiteti Shën Kirili dhe Metodi, 30 maj 2016

Ndërkohë Dr. Leka ka marrë pjesë dhe në trajnime, seminare, shkëmbime akademike dhe vizita profesionale dhe studimore. Këtu veçojmë:

- i. Trajnim përmes punëtorisë virtuale 'Hyrtje në Zhvillimin dhe Menaxhimin e Projekteve (Introduction to Project Design and Management)', organizuar nga Korpusi i Paqes, 15.09.2020

- ii. Trajnim përmes punëtorisë virtuale ‘Zhvillimi dhe Menaxhimi i Projekteve: Mjetet PACA (Project design and Management: PACA tools)’, organizuar nga Korpusi i Paqes, Maqedoni, 24.06.2020
- iii. Pjesëmarrje në Seminarin për Bashkëpunëtorët e Vullnetarëve të Korpusit të Paqes (Mid Service Conference), organizuar nga Korpusi i Paqes në Maqedoni, 6-7.02.2020
- iv. Punëtorja për Programin Evropa Kreative (Kategoria: projekte për bashkëpunim) pranë Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, organizuar nga Ministria e Kulturës, 25.10.2018
- v. Trajnim organizuar nga Matra Rule of Law me temë Integriteti i Nëpunësve Shtetëror, Hagë, Hollandë, 10-19.05.2016
- vi. Vizitë studimore në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në kuadër të Programit për leadership të vizitorëve ndërkombëtar (International Visitors Leadership Program), organizuar nga Programi i këmbimit të Departamentit të Shtetit, SHBA, 13-23.11.2016,
- vii. Trajnim në programet Microsoft Word, Microsoft Excel, Microsoft Office Power Point, Internet Explorer në Qendrën për kurse dhe Trajtime, Neting School, 19.09.2016
- viii. Vizitë pune në Normandi, Francë, me qëllim vendosjen e bashkëpunimit me Komunën e Lisieux, dhe këmbimin akademik të nxënësve të gjimnazit ‘Kiril Pejçinoviç’ Tetovë në gjimnazin ‘Marcel Gambier’ Lisieux, në kuadër të projektit ‘Promovim i paqes përmes bashkëpunimit të nxënësve ndër-etnik’. 29.09-03.10.2015
- ix. Vizitë pune në Bashkinë e Zagrebit, për këmbim përvojash në kuadër të projektit të UNDP-së ‘Futja e sistemit të integritetit në Komunën e Tetovës, Zagreb, Kroaci, 23-25.06.2014
- x. Vizitë pune në Qytetin e Bonit për vendosje të bashkëpunimit ndër-komunal dhe për ndjekje të ngjarjes Bon UN Talks on “United Nations Day”, 22-25.10.2014
- xi. Vizitë zyrtare në Stamboll për vendosje të marrëdhënieve diplomatike, thellim të bashkëpunimit politik, arsimor e ekonomik me partnerë turq. Në kuadër të vizitës u realizua takim zyrtar me Ministrin për Çështje Evropiane, Egemen Bagis, me biznesmenët e Odave Ekonomike “Tuskon”, “Iviad” dhe “Balkansiad”, takim me udhëheqësinë e Universitetit “Fatih”, vizitë në Kolegjin “Coşkun” - Çamlıca, vizitë në Kompleksin “Başbüyük Akademisi”, etj., 11-13.10.2013.
- xii. Seminar për Implementimin e Fondeve Strukturore: rregulloret dhe metodat, organizuar nga DATAR, zyra ndërinstitucionale për fondet strukturore të BE-së pranë zyrës së Kryeministrit të Francës, Paris, Francë, 18-20.10.2012
- xiii. Trajnim për Aftësi Komunikuese dhe Përgaditje për Intervistë Pune, organizuar nga USAID Competitiveness Project në Maqedoni, 21.12.2010.
- xiv. Program njëvjeçar akademik për Leadership dhe zhvillim të punës së rinisë në komunitet (60 ECTS), organizuar nga UEJL dhe qendra për arsimim joformal ‘Triagolnik’, Tetovë, Maqedoni 2008-2009.

#### Çertifikata

- Çertifikatë mirënjohjeje për pjesëmarrje në Konferencën për Zhvillim profesional të Vullnetarëve të Korpusit të Paqes (titulli origjinal: Certificate in Recognition of

the Participation in the Mid Service Conference for Professional Development of Peace Corpse Volunteers and their Counterparts), dhënë nga Korpusi i paqes në Maqedoni, 6-7.02.2020

- Çertifikatë për pjesëmarrje në Konferencën e 6 Ndërkombëtare Shkencore të Drejtësisë ‘Perspektivat Evropiane të Ballkanit Perendimor’ (titulli origjinal: Certificate of Participation in the 6th International Scientific Conference of Law “European Perspective of the Western Balkans”), dhënë nga Universiteti i Tetovës, 13-15.11.2019
- Çertifikatë për moderim të debatit akademik ‘Dhuna kundër grave dhe vajzave në Maqedoninë e Veriut gjatë pandemisë Kovid 19’ (titulli origjinal: Certification for moderating the academic debate “Violence against women and girls in North Macedonia during the period of Covid 19 pandemic”), dhënë nga Macedonian American Alumni Association, Universiteti i Tetovës, Ambasada Amerikane në Shkup, 10.12.2020
- Çertifikatë për mbarimin e kursit ‘Integriteti i Nëpunësve shtetëror’ (titulli origjinal: Certificate for successfully completing the course ‘Integrity of Civil Servants’), nga Akademia e Hagës për Qeverisje Lokale (the Hague Academy for Local Government), Komiteti i Helsinkit në Hollandë (the Netherlands Helsinki Committee) dhe (Shkolla e Drejtësisë së Lieden) Leiden Law School, 19.05.2017
- Çertifikatë për pjesëmarrje në Programin për Lidërsip të Vizitorëve Ndërkombëtarë për Shërbimet Komunale (titulli origjinal: Certificate for participating in the International Visitor Leadership Program on Municipal Service Delivery), dhënë nga Departamenti i Shtetit (United States Department of State, Bureau of Educational and Cultural Affairs), Nëntor, 2016
- Çertifikatë për pjesëmarrje dhe implementim të suksesshëm të procesit të vetë-vlerësimit në kuadër të Modelit CAF – Kornizë për Vetëvlerësim, në Komunën e Tetovës, nga Qendra për Menaxhim me Ndryshime, tetor 2013- prill 2014.
- Çertifikatë për Arritje të Larta Akademike (titulli origjinal: Certificate of Achievement with Honors for Outstanding Academic Results) gjatë studimeve në ciklin e parë, dhënë nga Universiteti i Evropës Juglindore, 11.06.2011
- Çertifikatë për pjesëmarrje në Simulimin studentor të Samitit të NATO-s (titulli origjinal: Certificate for Accomplishment for successful participation in the NATO SUMMIT STUDENT SIMULATION), dhënë nga Këshilli Euro-Atlantik i Maqedonisë (the Euro-Atlantic Council of Macedonia), 11.12.2010
- Diplomë për përvetësimin e vendit të dytë në Gara të Oratorisë, nga Lëvizja Evropiane e Republikës së Maqedonisë, 09.05.2010.
- Çertifikatë në Lidërsip dhe zhvillim të punës rinore në komunitet (titulli origjinal: Certificate in “Leadership and Developmental Community Youth Work (One year program 60 ECTS)”), dhënë nga Fakulteti i Administratës Publike dhe Shkencave Politike, dhe Qendrës Triagolnik për Arsimim jo-formal (Faculty of Public Administration and Political Science and Triagolnik Center for Non-formal Education), nëntor, 2009
- Çertifikatë për pjesëmarrje në Seminarin për Metodologji Hulumtuese (titulli origjinal: Certificate of Participation in the Seminar on Survey Methodology), dhënë nga University of New York Tirana dhe Qendra për Hulumtim e

Administratës Publike (Center for Research of Public Administration), 26-27.06.2009

- Certifikatë anëtarësi në Shoqërinë e Nderit Kombëtar të Shkollave të mesme (titulli original: Certificate of Membership in National Honor Society of Secondary Schools, awarded by National Association of Secondary School Principals, 2007

### MENDIM DHE PROPOZIM

Duke u nisur nga veprimtaritë e deritanishme të Dr. Gjeraqina Leka, dëshmuar përmes dokumentacionit të dorëzuar nga kandidatja, komisioni recenzues i vlerëson pozitivisht veprimtaritë mësimore – arsimore, shkencore – hulumtuese, profesionale dhe veprimtaritë tjera me interes të përgjithshëm të Dr. Lekës, duke e konsideruar këtë të fundit si kandidate me kompetencë për fushën në të cilën ajo konkurren. Komisioni recenzues konstaton se kandidatja Dr. Gjeraqina Leka, në përputhje me Ligjin për arsimin e lartë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe në përputhje me Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, shkencore, dhe mësimore-profesionale, si dhe thirrjet për bashkëpunëtorë të Universitetit të Tetovës, ka arritur **180.7** pikë, duke e tejkaluar numrin minimal të kërkuar për zgjedhjen në thirrjen mësimore-shkencore Docent në fushën e Marrëdhënieve ndërkombëtare dhe historisë së diplomacisë.

Me kënaqësi, i propozojmë Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Juridik të Universitetit të Tetovës, që: Dr. Gjeraqina A. Leka të zgjidhet në thirrjen mësimore-shkencore Docent në fushën Marrëdhënie Ndërkombëtare .

TETOVË, \_\_\_\_\_

### KOMISIONI RECENZUES

1. Prof. Dr. Shefik Shehu - kryetar
2. Prof. Dr. Ali Musliu - anëtar
3. Doc. Dr. Ebrar Ibraimi - anëtar



## SHTOJCË

### PËR RAPORTIN PËR ZGJEDHJE-RIZGJEDHJE NË THIRRJEN MËSIMORE-SHKENCORE, SHKENCORE DHE MËSIMORE-PROFESIONALE

Kandidati: Gjeraqina Leka

Institucioni: Fakulteti Juridik – UT, Tetovë

Fusha shkencore: Marrëdhënie ndërkombëtare dhe historia e diplomacisë

#### VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE

Nr. rendor	Emri i aktivitetit	Pikët
1.	<b>Mbajtja e ushtrimeve</b> (lëndët në studimet e ciklit të parë)	<b>Pikët: 6.3</b>
1.2.	Hyrje në shkencat politike	2 orë në javë x 15 javë në semestër x 2 semestra x 0.03 pikë = 1.8
1.3.	Integrimet në BE	2 orë në javë x 15 javë në semestër x 2 semestra x 0.03 pikë = 1.8
1.4.	Politika e jashtme e SHBA-së	1 orë në javë x 15 javë në semestër x 2 semestra x 0.03 pikë = 0.9
1.5.	Analiza e politikës së jashtme	2 orë në javë x 15 javë në semestër x 2 semestra x 0.03 pikë = 1.8
2.	<b>Mbajtja e ligjëratave</b> (lëndët në studimet e ciklit të parë)	<b>Pikët: 10.8</b>
2.1.	Të drejtat e njeriut	2 orë në javë x 15 javë në semestër x 1 semestër x 0.04 = 1.2
2.2.	Hyrje në shkencat politike	2 orë në javë x 15 javë në semestër x 2 semestra x 0.04 = 2.4
2.3.	Integrimet në BE	2 orë në javë x 15 javë në semestër x 2 semestra x 0.04 = 2.4
2.4.	Politika e jashtme e SHBA-së	2 orë në javë x 15 javë në semestër x 2 semestra x 0.04 = 2.4
2.5.	Analiza e politikës së jashtme	2 orë në javë x 15 javë në semestër x 2 semestra x 0.04 = 2.4
3.	<b>Konsultime me studentë</b>	<b>Pikët: 0.214</b>
3.1.	Të drejtat e njeriut	27 studentë x 1 semestër x 0.002 pikë = 0.054
3.2.	Hyrje në shkencat politike	10 studentë x 2 semestra x 0.002 = 0.04
3.3.	Integrimet në BE	10 studentë x 2 semestra x 0.002 = 0.04
3.4.	Politika e jashtme e SHBA-së	10 studentë x 2 semestra x 0.002 = 0.04

3.5.	Analiza e politikës së jashtme	10 studentë x 2 semestra x 0.002 = 0.04
4.	<b>Recenzent i punimeve në fushën e veprimtarisë mësimore-edukative</b>	<b>Pikë: 46</b>
4.1.	International Journal of Legal Sciences 2020	15 artikuj x 2 pikë = 30
4.2.	International Journal of Legal Sciences 2021	8 artikuj x 2 pikë = 16
	<b>Gjithsej</b>	<b>63.3</b>

#### VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE

Nr. rendor	Emri i aktivitetit	Pikët
5.	<b>Artikuj me rezultate shkencore origjinale, të publikuara në revistë referente shkencore/profesionale me bord redaktues ndërkombëtar</b>	<b>Pikët: 14.4</b>
5.1.	<b>Gjeraqina Leka:</b> Security oriented foreign policy: theoretical approach, <i>International Journal of Legal Sciences</i> , Vol. 9 No. 13-14, Jun. 2021.	3
5.2.	<b>Gjeraqina Leka:</b> The role of foreign policy threats on inter-ethnic relations, <i>International Journal of Innovation and Scientific Research</i> , Vol. 49 No. 1 Jun. 2020, pp. 197-205	3
5.3.	<b>Gjeraqina Leka:</b> North Macedonia within the western Balkan sub-regional security complex: A theoretical approach, <i>International Journal of Innovation and Scientific Research</i> , Vol. 49 No. 2 Jul. 2020, pp. 206-215	3
5.4.	Shefik Shehu & <b>Gjeraqina Leka:</b> Gjuha e urrejtjes: një pasqyrim normativ (në botim), Botim i veçantë në kuadër të projektit hulumtues: Hate speech during the campaign of the 2020 parliamentary elections in the RNM: perceived effects on the behaviour of citizens in intergroup relations, Universiteti i Tetovës, 2020	3 x 0.9 = 2.7
5.5.	Shefik Shehu & <b>Gjeraqina Leka:</b> Small States' Security Through International Integrations: A Theoretical Approach, <i>Justicia</i> , Vol. 8, pp.199-206	3x 0.9 = 2.7

6.	<b>Ligjërime plenare në konferencë shkencore me pjesëmarrje ndërkombëtare</b>	<b>Pikët: 8</b>
6.1.	Small States' Security Through International Integrations: A Theoretical Approach, prezantuar në: 6th International Scientific Conference of Law "European Perspective of the Western Balkans", Universiteti i Tetovës, 13-15 nëntor 2019	2
6.2.	Methodology of Empirical Data Collection, prezentuar në Konferencën Vjetore të Fakultetit Filozofik, Universiteti Shën Kirili dhe Metodi, 13 maj 2019	2
6.3.	The Interplay between Domestic and Foreign Policy, prezentuar në Konferencën Vjetore të Fakultetit Filozofik, Universiteti Shën Kirili dhe Metodi, 25 prill 2018	2
6.4.	To what extent does the halt of the EU integration process fuel nationalistic policies in Macedonia and consequently contribute to the inter-ethnic instability of the country? prezentuar në Konferencën Vjetore të Fakultetit Filozofik, Universiteti Shën Kirili dhe Metodi, 30 maj 2016	2
7.	<b>Pjesëmarrës në projekt shkencor ndërkombëtar</b>	<b>Pikët: 11</b>
7.1.	Koordinatorë nacionalë në projektin ndërkombëtar shkencor Cradle for Excellence in Social Sciences and Humanities (CROSS)	6
7.2.	Anëtare në projektin ndërkombëtar shkencor AURORA EUA	5
	<b>Gjithsej</b>	<b>33.4</b>

#### VEPRIMTARIA PROFESIONALE-APLIKATIVE

Nr. rendor	Emri i aktivitetit	Pikët
8.	<b>Përkthyes</b>	<b>Pikët: 13</b>
8.1.	International Journal of Human Sciences "Filologjia" numri special për Nënë Terezë.	13 artikuj x 1 pikë = 13
9.	<b>Lektor</b>	<b>Pikët: 58</b>
9.1.	<b>Revista shkencore</b>	

10.1.1.	Journal of Educational Research “Education” 2019	23 artikuj x 1 pikë = 23
10.1.2.	Journal of Applied Sciences 2019	15 artikuj x 1 pikë = 15
10.1.3.	Journal of Sports and Health 2018	20 artikuj x 1 pikë= 20
10.	<b>Pjesëmarrje në tubim shkencor / profesional / vizita studimore / këmbime akademike</b>	<b>Pikët: 8</b>
10.1.	Këmbim akademik Erasmus + në Universitetin e Stambollit, Stamboll, Turqi, 21-25, qershor, 2021	1
10.2.	Punëtori virtuale ‘Hyrje në Zhvillimin dhe Menaxhimin e Projekteve (Introduction to Project Design and Management)’, organizuar nga Korpusi i Paqes, 15.09.2020	1
10.3.	Punëtori virtuale ‘Zhvillimi dhe Menaxhimi i Projekteve: Mjetet PACA (Project design and Management: PACA tools)’, organizuar nga Korpusi i Paqes, Maqedoni, 24.06.2020	1
10.4.	Seminar për Bashkëpunëtorët e Vullnetarëve të Korpusit të Paqes (Mid Service Conference), organizuar nga Korpusi i Paqes në Maqedoni, 6-7.02.2020	1
10.5.	Punëtori për Programin Evropa Kreative (Kategoria: projekte për bashkëpunim) pranë Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, organizuar nga Ministria e Kulturës, 25.10.2018	1
10.6.	Program studimor 10 ditor, Matra Rule of Law me temë Integriteti i Nëpunësve Shtetëror, Hagë, Hollandë, 10-19.05.2016	1
10.7.	Vizitë studimore në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në kuadër të Programit për lidhshmëri të vizitorëve ndërkombëtar (International Visitors Leadership Program), organizuar nga Programi i këmbimit të Departamentit të Shtetit, SHBA, 13-23.11.2016	1
10.8.	Trajnim në programet Microsoft Word, Microsoft Excel, Microsoft Office Power Point, Internet Explorer në Qendrën për kurse dhe Trajnime, Neting School, 19.09.2016	1
	<b>Gjithsej</b>	<b>79</b>

**VEPRIMTARITË ME INTERES MË TË GJERË**

<b>Nr. rendor</b>	<b>Emri i aktivitetit</b>	<b>Pikët</b>
11.	<b>Anëtar i këshillit editorial të revistës shkencore ndërkombëtare</b>	<b>Pikët: 1</b>
11.1.	Revista ndërkombëtare Justicia	1
12.	<b>Anëtar i komisionit universitar</b>	<b>Pikët: 1</b>
12.1.	Komisioni për regjistrim të studentëve në ciklin e parë (2019-2020)	1
13.	<b>Udhëheqës</b>	<b>Pikët: 3</b>
13.1.	Zyra për Menaxhim dhe Përpilim të Projekteve (2019 - )	3
	<b>Gjithsej</b>	<b>5</b>

<b>REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATIT PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJEN</b>	<b>Pikët</b>
<b>VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE</b>	<b>63.3</b>
<b>VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE</b>	<b>33.4</b>
<b>VEPRIMTARIA PROFESIONALE-APLIKATIVE</b>	<b>79</b>
<b>VEPRIMTARITË ME INTERES MË TË GJERË</b>	<b>5</b>
<b>Gjithsej</b>	<b>180.7</b>

Tetovë, më qershor, 2021

Anëtarët e komisionit recenzues:

Prof. Dr. Shefik Shehu (kryetar)

---

Prof. Dr. Ali Musliu (anëtar)

---

Doc. Dr. Ebrar Ibraimi (anëtar)

---